



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 838 Prot.

Tiranë, më datë 21.08.2020

VENDIM

Nr. 294, datë 21.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit dhe raportit të vëzhgimit arkeologjik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.08.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit zhvillimor “Kompleks rezidencial “Objekt me funksion banimi deri në 3 kate, në varësi të terrenit, me mur rrethues” me investitor Z. Skënder Plaku dhe raporti i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor i realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji K.A.E.XH;
 2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “Kompleks rezidencial “Objekt me funksion banimi deri në 3 kate, në varësi të terrenit, me mur rrethues” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
 4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

